



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING	
Njësia Org Org./Jedinka Org./Unit	DMM
Nr. Prot. Org./Prot. Prot./No.	5393-2/26
Nr. i kopjeve Broj stranica No. pages	5
Data Datum Date:	25.09.26
PRISHTINËJA	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit / Department of Environment Protection /
Departament za Zaštitu Sredine

DATE/A:	24.09.2026
REFERENC-Ë:	26/5393/MMPH/704/DMM
PËR/ZA/TO:	"Pista-Ekoplast" Sh.p.k., Rahovec
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së Miradije Gërguri, U.D. Drejtore e DMM-së Rizah Muçolli, Udhëheqës i DLLM-së
NGA/OD/FROM:	Ekrem Hetemi, Zyrtar i Lartë për Mbeturina
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Leje për Import të Mbeturinave

Sipas kërkesës së juaj me nr. prot. 26/5393/MMPH/704/DMM, datë 21.09.2026, MMPH ka shqyrtuar kërkesën dhe ka vendosur si në vijim.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 29 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2024, për Përcaktimin e Kushteve, Kriterëve dhe Procedurave për Lëshimin e Lejes për Import, Eksport dhe Kalim Tranzit të Mbeturinave, nenit 40, paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina si dhe nenit 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nxjerr këtë:

VENDIM

Aprovohet kërkesa e kompanisë "Pista-Ekoplast" Sh.p.k., Rahovec, me nr. prot. 26/5393/MMPH/704/DMM, datë 21.09.2026, për Leje Importi të Mbeturinave nga kompania:

1. "RIKI TREJD KOM."

Adresa: Pekarev, 1440 Negotino/Republika e Maqedonisë së Veriut.

Nr. i notifikimit: RKS 0080/5393-704/26

Vendi i origjinës së mbeturinave: Republika e Maqedonisë së Veriut.

Importuesi: "Pista-Ekoplast" Sh.p.k., Rahovec

Objekti për trajtim/Riciklim: "Pista-Ekoplast" Sh.p.k., Rahovec, Fabrikë për riciklimin e termoplasteve dhe prodhimi i gypave fleksibil.



Lloji dhe sasia e mbeturinave

Lloji i mbeturinës	Kodi sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave	Sasia/ton
Plastikë dhe gomë	19 12 04	300

Informacionet për pikën hyrëse, dalëse dhe rrugën e transportit të mbeturinave

Nr.	Vendi i dërgimit	Pika e hyrjes në Kosovë	Vendi i pranimit
1.	Republika e Maqedonisë së Veriut	Hani i Elezit	Republika e Kosovës

Vlefshmëria e Lejes: Leja është e vlefshme nga data **24.09.2026** deri më **22.09.2027**.

Kompania në fjalë është e obliguar të bëjë transportimin e mbeturinave duke iu përmbajtur kushteve të Marrëveshjes Evropiane për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR) dhe Rregullave në lidhje me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme me hekurudhë (RID).

Kompania është e detyruar që t'iu dërgoj kopjet e nënshkruara të dokumentit shoqërues të autoriteteve kompetente përkatëse të paktën tri (3) ditë pune para datës së fillimit të dërgesës.

Kompania në fjalë, është e obliguar ta njoftoj MMPH-në me shkrim, për realizimin e importit të mbeturinave në sasinë e lejuar për të cilën lëshohet Leja.

Sipas Ligjit Nr. 04/L-060 Për Mbeturina dhe Ligjit Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina:

Ndalohet importimi i mbeturinave të rrezikshme në Republikën e Kosovës.

Ndalohet importimi i mbeturinave të pa rrezikshme për qëllime deponimi dhe djegie, duke përjashtuar rastet kur mbeturinat importohen si lëndë e parë për riciklim në impiantin e lejuar nga Ministria.

Importimi i mbeturinave jo të rrezikshme në Republikën e Kosovës lejohet, nëse për objektet dhe pajisjet, në të cilat trajtohen mbeturinat, operatorët e posedojnë lejen përkatëse për trajtimin e mbeturinave jo të rrezikshme, të lëshuar nga Ministria. Përjashtimisht, **ndalohet importimi i mbeturinave jo të rrezikshme për qëllime të:**

- ruajtjes së përkohshme të mbeturinave;



- deponimit të mbeturinave në deponi të mbeturinave, të pajisura me leje përkatëse mjedisore, ose në ndonjë vend tjetër;
- trajtimit me djegie të mbeturinave për përfitim të energjisë, në cilin do impiant të pajisura me leje përkatëse mjedisore;
- asgjësimit të mbeturinave me cilëndo metodë të mundshme.

Në rast se dërgesa nuk kryhet siç është planifikuar ose/dhe në rast të dërgimit të paligjshëm të mbeturinave, operatori është i obliguar t'iu përmbahet kushteve të përcaktuara në nenet 24 dhe 25 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2024, për Përcaktimin e Kushteve, Kritereve dhe Procedurave për Lëshimin e Lejes për Import, Eksport dhe Kalim Tranzit të Mbeturinave.

Kompania në fjalë është e obliguar të përmbahet Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina, Ligjit Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2024, për Përcaktimin e Kushteve, Kritereve dhe Procedurave për Lëshimin e Lejes për Import, Eksport dhe Kalim Tranzit të Mbeturinave për importimin e mbeturinave për të cilat lëshohet kjo leje.

Bashkëngjitur në këtë vendim është Dokumenti për Notifikim lidhur me qarkullimin ndërkufitarë të mbeturinave.



Arsyetim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të kërkesës me nr. prot. 26/5393/MMPH/704/DMM, datë 21.09.2026, të kompanisë "Pista-Ekoplast" Sh.p.k., Rahovec, për Leje Importi të Mbeturinave me nr. të kodit 19 12 04 sipas Udhëzimit Administrativ përkatës për Katalogut Shtetëror të Mbeturinave:

Vlerëson se nga kompania janë prezantuar dokumentet dhe shënimet e nevojshme sipas nenit 5, 6, 7, 10, 16 dhe 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2024, për Përcaktimin e Kushteve, Kritereve dhe Procedurave për Lëshimin e Lejes për Import, Eksport dhe Kalim Tranzit të Mbeturinave dhe sipas nenit 56 të Nr.04/L-060 për Mbeturina dhe nerit 40 të Ligjit Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina dhe i lëshohet leja për import të mbeturinave.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat kohor prej 30 ditësh nga dita e lëshimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr. 5393 /26-ZSP/

/26,

datë: 24.09.2026

Prishtinë

Vendimi t'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Zyrës së Sekretarit
3. DMM-së
4. Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore
5. Inspektoratit të MMPH-së
6. Kabinetit të Ministrit/es
7. Arkivit të MMPH-së



U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të
MMPH-së